



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË SHËRBIMIT TË LUNDRIMIT AJROR

Nr. 645 prot.

Tiranë, më 22.04.2020

VENDIM

Nr. 30, datë 22.04.2020

PËR

DHËNIEN E PËRJASHTIMIT NGA PARASHIKIMET E URDHËRIT TË MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NR. 91, DATË 21.02.2019, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TEKNIKE DHE PROÇEDURAVE ADMINISTRATIVE NË LIDHJE ME LIÇENSAT DHE ÇERTIFIKATAT E KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR"

Në bazë të Nenit 14 të Udhëzimit të Ministrit Nr. 3, datë 07.02.2011 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil", i ndryshuar, në vijim të kërkesës së subjektit "Albcontrol Sh.a.", mbi zbatim e parashikimeve të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturrës dhe Energjisë Nr. 91, datë 21.02.2019, "Për Miratimin e Rregullores mbi Përcaktimin e Kërkesave Teknike dhe Proçedurave Administrative në Lidhje me Liçensat dhe Çertifikatat e Kontrollorëve të Trafikut Ajror", Autoriteti i Aviacionit Civil vlerësoi rrethanat e kufizimeve drastike të fluturimeve dhe mbylljeve të kufijve midis shumicës së shteteve prej pandemisë Covid-19, konsideroi analizën e riskut të hartuar nga Albcontrol.

Nisur nga sa më sipër,

V E N D O S A:

1. Dhënie e përjashtimit për pjesët KTA.B.035, të Aneksit I, Nën pjesa B, dhe pjesën KTA.C.020 të Aneksit I, Nën pjesa C, nga Urdhri i Ministrit të Infrastrukturrës dhe Energjisë Nr. 91, datë 21.02.2019, "Për Miratimin e Rregullores mbi Përcaktimin e Kërkesave Teknike dhe Proçedurave Administrative në Lidhje me Liçensat dhe Çertifikatat e Kontrollorëve të Trafikut Ajror".
2. Ky përjashtim është i vlefshëm 4 (katër) muaj nga data e lëshimit.
3. Ky përjashtim zbatohet për Albcontrol Sh.a.
4. Ky përjashtim është subjekt i kushteve të mëposhtme:
 - përmbushja e kriterëve të mitigimit sipas vlerësimit të riskut.

DREJTOR EKZEKUTIV

Edlira Kraja

